



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKT VENDIM

Nr. _____, datë _____. ____ 2024

“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR KUSHTET DHE KRITERET E USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË STACIONIT TË PLAZHIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 64, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, sipas tekstit dhe shtojcave 1 dhe 2, bashkëlidhur këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.
2. Vendimi nr. 171, datë 27.3.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’, i ndryshuar, shfuqizohet.
3. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e turizmit, Drejtoria e Përgjithshme Detare, Policia Kufitare dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

RREGULLORE

PËR KUSHTET DHE KRITERET E USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË STACIONIT TË PLAZHIT

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore përcakton kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacioneve të plazhit në të gjitha zonat bregdetare, si dhe në bregun e liqeneve e të lumenjve, të cilat janë identifikuar si zona të përshtatshme për plazhe, me qëllim ofrimin e kushteve të përshtatshme e të standardeve cilësore për pushuesit.

Neni 2

Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëtin kuptim me atë të përcaktuar në nenin 4, të ligjit nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar.

2. Përveç tyre, në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Grupi Teknik i Shqyrtimit të Aplikimeve (në vijim "GTSHA")" është autoriteti i shqyrtimit të kërkesave për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi, sipas parashikimeve të këtij vendimi.

b) "Komiteti i menaxhimit të sezonit turistik" është organ i krijuar sipas parashikimeve të këtij vendimi.

c) "Plazh", zona me rërë, zhavorr apo shkëmb, që shtrihet në buzë të ujit të detit, lumi apo liqenit, e cila është pronë ekskluzive e shtetit dhe administrohet nga njësia e vetëqeverisjes vendore, e hapur për përdorim të lirë publik dhe që është identifikuar si e përshtatshme për zonë çlodhjeje, argëtuese e që konsiderohet e parrezikshme nga pikëpamja shëndetësore apo e sigurisë për përdorim nga pushuesit;

ç) "Plazh i lejuar", ku lejohet të ushtrohet veprimtaria e stacionit të plazhit sipas kushteve dhe kritereve të kësaj rregulloreje;

d) "Plazh publik", zona të plazheve të lejuara dhe të administruara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, të hapura për përdorim publik e që ofrojnë kërkesa minimale për sigurinë dhe higjenën;

dh) "Plazh i virgjër", plazhet në të cilat nuk lejohet asnjë veprimtari për stacion plazhi, përveç mirëmbajtjes dhe pastrimit të mbeturinave nga njësia e vetëqeverisjes vendore për sa është e mundur.;

e) "Vrojtues plazhi", është personi i kualifikuar dhe i certifikuar nga Qendrat e Formimit Profesional për vrojtues plazhi, për të shpëtuar jetën në ujë dhe për të dhënë ndihmën e parë mjekësore.

ë) "Zonë shërbimesh", zona ku ndodhen shërbimet higjeno-sanitare, kabinat e veshjes dhe baret.

Neni 3

Tipologjia e plazheve

1. Plazhet në bazë të vijës së bregut të detit ose të liqenit dhe të karakteristikave të tjera natyrore ndahen në plazhe të tipit A, B, AB e C:

a) Plazh i tipit A është plazhi kryesisht me përbërje ranore dhe gjerësi të konsiderueshme të brezit të plazhit, e cila nuk është më e vogël se 60 (gjashtëdhjetë) m vijë perpendikulare me vijën e bregut të detit ose të liqenit;

b) Plazh i tipit B është plazhi kryesisht me përbërje shkëmbore dhe zhavorri dhe me gjerësi të brezit të plazhit, e cila nuk është më e madhe se 60 (gjashtëdhjetë) m vijë perpendikulare me vijën e bregut të detit ose liqenit;

c) Plazh i tipit AB është plazhi i ndërthurur, i cili përmban karakteristika si të tipave A e B;

ç) Plazh i tipit C është plazhi i virgjër, për përdorim të lirë, në të cilin nuk lejohet asnjë veprimtari për stacion plazhi, përveç mirëmbajtjes dhe pastrimit, nga njësia e vetëqeverisjes vendore që e ka në administrim.

2. Hapësirat e plazheve të lejuara, të cilat nuk janë dhënë në përdorim për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, janë për përdorim publik dhe administrohen, menaxhohen e mirëmbahen nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

Neni 4

Harta e përgjithshme për plazhet e lejuara

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme Detare, përgatisin hartën e përgjithshme për plazhet e lejuara. Kjo hartë përban, si më poshtë vijon:

a) hapësirat e plazhit për të ushtruar veprimtari si stacion plazhi;

b) hapësirat e plazhit publik;

c) hapësirën ujore të lejuar për notim (zonë e rrëthuar me bova);

ç) vendbazimet e mjeteve lundruese dhe korridoret e lëvizjes së tyre

2. Ndarja e sipërfaqes së plazhit të lejuar si plazh privat/publik do të kryhet sipas gjatësisë në vijë lineare të hartës së propozuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore përkatëse, ku në çdo 1000m vijë lineare, 300 m vijë linear plazh, të përcaktohen si parcela publike, shpërndarja e të cilave në hartë, vlerësohet nga njësia e qeverisjes vendore rast pas rasti sipas tipologjisë së secilit plazh.

3. Harta e përgjithshme e plazheve propozohet nga njësia e vetëqeverisjes vendore përkatëse dhe miratohet brenda muajit Tetor, nga Komiteti i Menaxhimit të Sezonit Turistik.

4. Agjencia Kombëtare e Bregdetit në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore, deri në datën 1 maj, të çdo viti, të lidhin të gjitha kontratat e qirasë për përdorimin e stacionit të plazheve.

5. Plazhet për të cilat nuk është lidhur kontratë deri në datën e përaktuar në pikën 4, funksionojnë si plazhe publike dhe adminisitrohen/menaxhohen e mirëmbahen nga njësitet e vetëqeverisjes vendore përkatëse.

Neni 5

Komiteti i Menaxhimit të Sezonit Turistik

1. Komiteti i Menaxhimit të Sezonit Turistik (këtu e në vijim KMST), kryesohet nga ministri i Turizmit dhe Mjedisit dhe, në përbërje të tij, ka përfaqësues të nivelit të lartë nga:

- a) Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- b) Ministria e Infrastrukturës dhe Enerjisë;
- c) Ministria e Mbrojtjes;
- ç) Ministria e Brendshme;
- d) Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;
- dh) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- e) Ministri për Pushtetin Vendor;

dhe asistohet nga Task-Forca Ndërinstitucionale e Sezonit Turistik, e ngritur me urdhër të Kryeministrat.

2. Sipas rastit, Komiteti i Menaxhimit të Sezonit Turistik mund të këshillohet me përfaqësues të njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore, ekspertë të fushës së turizmit dhe përfaqësues të institucioneve të tjera.

3. KMST ka si detyrë:

- a) miratimin e listës së plazheve dhe hartës së stacioneve të plazheve, sipas tipologjive të tyre, si dhe plazheve publike, bazuar në propozimet e njësive të vetëqeverisjes vendore, të cilat pajisen me një numër të veçantë identifikues, që publikohet në momentin e hapjes së kërkësës online;
- b) miratimin e afatit të lidhjes së kontratës për përdorimin e hapsirës së plazhit nga subjektit private;
- c) monitorimin e mbarëvajtjes së sezonit turistik, që përfshin periudhën 1 Maj deri në 15 Nëntor, si dhe koordinimi ndërinstitucional për respektimin e masave dhe të detyrimeve të çdo institucioni përgjegjës sipas detyrave funksionale respektive.

4. Mënyra e organizmit dhe e funksionimit të KMTS-së miratohet me urdhër të ministrit të Turizmit dhe Mjedisit.

Neni 6

Njësia e Vetëqeverisjes Vendore

1. Njësia e vetëqeverisjes vendore (në vijim "NJVV"), është përgjegjese për:
 - a) administrimin dhe menaxhimin e hapësirave të plazhit publik;
 - b) pastrimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave të plazhit;

- c) pajisjen me infrastrukturën mbështetëse dhe ndarjen me sinjalistikën përkatëse të plazheve, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - ç) vendosjen e sinjalistikës së dallueshme për cdo tipologji plazhi, që është plazh publik;
 - d) për mbledhjen e detyrimeve të qirasë për çdo vit;
 - dh) miratimin e vendbazimeve të mjeteve lundruese dhe korridoret e lëvizjes së tyre, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme Detare dhe strukturat e Policisë Kufitare;
2. NJVV në rast se menaxhon hapësira të konsideruara si plazhe publike garanton kushtet minimale të stacioneve të plazhit, sipas tipologjisë dhe kërkesave të sigurisë, të parashikuar në këtë rregullore. Pjesa tjetër e plazhit publik mirëmbahet nga NJVV, duke siguruar vendosjen e tabela informues, sipas parashikimeve të kësaj rregulloreje.
3. Policia Bashkiake e NJVV-së përkatëse është përgjegjëse për mbikqyrjen dhe ruajtjen e hapësirave të plazheve publike si dhe ,marrjen e masave të menjëherëshme për rastet e parashikuara në pikat 5 dhe 6 të nenit 8 të kësaj rregulloreje.

Neni 7

Kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit

1. Në stacionin e plazhit ushtrojnë veprimtarinë subjektet që plotësojnë kriteret e kësaj rregulloreje dhe që lidhin një kontratë qiraje për përdorimin e hapësirës së plazhit, në varësi të kapacitetit të strukturës akomoduese si dhe rast pas rast njësitë e vetqeverisjes vendore përkatëse.
2. Në rastin e kërkesave të projekteve me potencial strategjik, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, apo kërkesave të investitorëve në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, kontrata për përdorimin e hapësirës së plazhit lidhet sipas akteve ligjore dhe nënligjore përkatëse.
3. Kur veprimtaria e stacionit të plazhit ushtrohet nga subjektet private, subjekti përmblush kriteret, si mëposhtë:
 - a) të jetë i regjistruar si person fizik/tregtar apo juridik, për ushtrimin e veprimtarisë si strukturë akomoduese;
 - b) të disponojë një strukturë akomoduese të kategorizuar nga ministria përgjegjëse për turizmin, me hapësirë plazhi para/në afërsi të strukturës akomoduese;
 - c) të ketë shlyer të gjitha detyrimet tatimore qëndrore dhe detyrimet vendore;
 - ç) të ketë një plani operimi për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, duke përfshirë kushtet minimale dhe kërkesat e sigurisë për stacionin e plazhit.
4. Autoriteti përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave për dhënen në përdorim të stacionit të plazhit është Grupi Teknik i Shqyrtimit të Aplikimeve (në vijim “GTSNA”). Përbërja dhe mënyra e funksionimit të GTSNA-së miratohen me urdhër ministri.
5. GTSNA-jn në dhënen në përdorim të hapësirës së plazhit për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit:
 - a) i jep përparësi sipas radhës:

i) subjektit që disponon një strukturë akomoduese të kategorizuar nga ministria përgjegjëse për turizmin, me hapësirë plazhi para strukturës akomoduese;

ii) subjektit që disponon një strukturë akomoduese të kategorizuar nga ministria përgjegjëse për turizmin, me hapësirë plazhi në afërsi të strukturës akomoduese

b) cakton dhe miraton numrin e çadrave, në varësi të numrit të dhomave të deklaruara nga subjekti. Për përcaktimin e numrit të çadrave GTSNA mban në konsideratë numrin e dhomave të strukturës akomoduese duke e llogaritur në raportin 1 dhomë, 2 çadra.

6. Subjekti që plotëson kriteret e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, aplikon në portalin *e-Albania* për marrjen në përdorim të hapësirës së plazhit për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi, brenda afatit/eve të përcaktuar, në njoftimin në faqen zyrtare të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

7. Në fazën e parë të aplikimit, subjekti ngarkon në portalin *e-Albania* dokumentacionin e mëposhtëm:

a) formularin e kërkesës online, sipas numrit përkatës identifikues të stacionit të plazhit.

b) formularin e vetëdeklärimit mbi kapacitetin e strukturës akomoduese, numrin e dhomave;

c) planin e operimit për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi, sipas formatit të publikuar online;

ç) foto të jashtme të qarta të strukturës akomoduese, të cilat të identifikojnë strukturën akomoduese në raport me hapësirën e plazhit, si dhe foto të qarta të hapësirës së plazhit për të cilën aplikohet;

d) vetëdeklärimin se subjekti është njojur me kushtet, kriteret dhe kërkesat për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit dhe mban përgjegjësi të plotë për plotësimin dhe zbatimin tyre, sipas ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi;

8. GTSNA-ja, për shqyrtimin e kërkesave, ndjek procedurën e mëposhtme:

a) shqyrton dokumentacionin e paraqitur dhe në rast se konstatohet mungesë apo paqartësi dokumentacioni, njofton menjëherë subjektin nëpërmjet portalit *e-Albania* për afatin dhe plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm;

b) në rast se subjekti nuk i plotëson kriteret, dhe/ose dokumentacioni, Brenda afatit të kërkuar dhe kërkesë për aplikim mbetet e paplotësuar, GTSNA-ja refuzon përfundimisht kërkesën nëpërmjet portalit *e-Albania*;

c) në rast se subjekti i plotëson kriteret dhe dokumentacioni i paraqitur rezulton i plotë, GTSNA-ja njofton subjektin nëpërmjet portalit *e-Albania* për fazën e dytë të procedurës dhe njofton elektronikisht Agjencinë Kombëtare të Bregdetit (në vijim "AKB") dhe njësinë përkatëse të vetëqeverisjes vendore, me qëllim plotësimin e dokumentacionit shtesë.

9. Në fazën e dytë të aplikimit, subjekti brenda datës 31 mars, ngarkon në portalin *e-Albania* dokumentacionin e mëposhtëm:

a) planvendosjen përkatëse të stacionit të plazhit, ku të specifikohet numri i çadrave duke mbajtur në konsideratë distancat e parashikuara në këtë rregullore, dhe sipërfaqen konkrete, e cila nuk duhet të tekalojë numrin e çadrave të miratuar të stacionit të plazhit., e negociuar nga subjekti dhe NJVV.

b) gjenerimin i mandatpagesës vjetore të sipërfaqes së stacionit të plazhit, nga ana e NJVV-së si palë përfituese, sipas tarifave vendore në fuqi, ku të detajohet detyrimi financiar vjetor për përdorimin e sipërfaqes së stacionit të plazhit dhe vërtetimi i pagesës së kryer nga ana e subjektit.

c) vërtetimin nga autoritetet tatinore se subjekti ka shlyer të gjitha detyrimet tatinore qëndrore dhe detyrimet vendore;

ç) marrëveshjen e noterizuar me vrojtuesin e plazhit (shoqëruar me certifikatën përkatëse të kualifikimit), e vlefshme përgjatë gjithë kohëzgjatjes sipas afatit të parashikuar në pikën 13 të këtij neni.

10. Pas plotësimit të dokumentacionit të mësipër, GTSHA-ja miraton në portalin *e-Albania* aplikimin përkatës dhe AKB-ja njofton menjëherë subjektin dhe NJVV-në për nënshkrimin e kontratës. Modeli kontratës tip që AKB-ja nënshkruan me subjektin, është sipas shtojcës 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

11. Dorëzimi i hapësirës së plazhit bëhet, si më poshtë vijon:

a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës, topografi i njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore ndan me procesverbal në terren koordinatat e stacionit të plazhit dhe njofton policinë bashkiakë për monitorimin e veprimtarisë;

b) një kopje e procesverbalit depozitohet pranë zyrës qendrore të AKB-së brenda 10 (dhjetë) ditëve nga momenti hartimit të tij.

12. Kontrata për dhënen në përdorim të hapësirave të plazhit nënshkruhet me afat nga 1 (një) deri në 5 (pesë) vjet, sipas vendimmarrjes të KMST-së.

13. Periudha brenda të cilës ushtrohet veprimtaria e stacionit të plazhit është nga 1 maj deri më 15 nëntor të çdo viti dhe kur subjekti ushton veprimtarinë ofron të gjitha shërbimet dhe përmbushen të gjitha kushtet minimale të përcaktuara, në bazë të tipologjisë së plazhit ku do të ushtrohet aktiviteti.

Neni 8

Kushtet minimale të stacionit të plazhit sipas tipologjisë së plazhit

1. Kushtet minimale që duhet të përmbushë një stacion plazhi, në plazhet e tipit A, janë, si më poshtë vijon:

a) për çadrat dhe ndenjëset e pushuesve të respektohet një distancë prej të paktën 10 (dhjetë) m nga vija e bregut të detit, likenit;

b) hapësira prej 2.5 (dy pikë pesë) m përpara brezit të parë të çadrave të jetë e lirë për t'u shfrytëzuar nga publiku;

c) hapësira midis çadrave (nga çadra në çadër) nuk duhet të jetë më e vogël se 3 (tre) m në linjë horizontale me vijën e ujit, si dhe jo më e vogël se 2.5 (dy pikë pesë) m në linjë vertikale me vijën e ujit;

ç) të ketë në dispozicion të pushuesve 1 (një) dush me ujë të ëmbël;

d)) të jetë i pajisur me shërbime higjenike, minimalisht të ketë 1 tualet të ndarë në njësi për femra dhe meshkuj dhe 1 (një) për njerëzit me aftësi të kufizuara; njësi për njerëzit me aftësi të kufizuara mund të përfshihet në secilën njësi për femra dhe meshkuj, duke rritur sipërfaqen e këtyre njësive të shërbimit në dimensionet maksimale 1,80 m x 1,80 m;

- dh) të ketë kabina zhveshjeje, sipërfaqja totale e kabinave të zhveshjes nuk duhet të jetë më e vogël se 1 (një) % e sipërfaqes së hapësirës së plazhit të dhënë në përdorim;
- e) të jetë i pajisur me zonën e ndihmës së shpejtë në shërbim të pushuesve, si dhe me pajisjet përkatëse për dhënien e ndihmës së shpejtë për pushuesit; ky ambient duhet të jetë lehtësishët i aksesueshëm dhe i identifikueshëm dhe të lihen korridore të lira kalimi për transportin në raste emergency;
- ë) prania e tabelave informuese, të vendosura në vende të dukshme, me numrat e telefonit të Ambulancës, Policisë, Zjarrfikëses, Kapitanerisë së Portit, QNOD-it;
- f) të jetë i pajisur me kontejnerë dhe kosha me kapak për hedhjen e mbeturinave;
- g) çdo çadër duhet të jetë i pajisur me 2 (dy) krevate plazhi;
- gj) afishimit të kritereve dhe kushteve të sigurisë së shëndetit dhe jetës për aspektet teknike të veprimtarisë së stacionit të plazhit.
- h) të ekspozojë në vend të dukshëm për publikun emrin e biznesit, si dhe procedurën e ankimit të paktën në gjuhën shqipe dhe angleze.
- i) të ekspozojë dukshëm listat e çmimeve për produktin dhe shërbimin që ofron të paktën në gjuhën shqipe dhe angleze.
- j) stafi që shërben pranë stacioneve të plazhit të ketë uniforme dalluese;
- k) të zbatojë kodin e etikës globale në fushën e turizmit;
- l) detyrimin të mirëmbajë dhe të parandalojë ndotjen e hapësirës së plazhit që ka marrë në përdorim nëpërmjet shërbimit për pastrimin dhe mirëmbajtjen e stacionit të plazhit të jetë ditor, në mëngjes dhe në mbrëmje pas mbylljes së plazhit. Po ashtu, gjatë orarit të hapjes së stacionit të plazhit duhet të sigurohet vazhdimësia e pastërtisë dhe boshatisja e koshave të mbeturinave;
- ll) në të gjithë territorin e plazhit ndalohet vendosja e elementeve ndarëse, gardhe apo të tjera të ngjashme me to.

2. Kushtet minimale që duhet të plotësojë një stacion plazhi, në plazhet e tipit B, janë, si më poshtë vijon:

- a) për çadrat dhe ndenjëset e pushuesve ne varësi të hapsirës, të respektohet një distancë prej 2.5-3 (tre) m nga vija e bregut të detit, lijenit;
- b) hapësira midis çadrave (nga çadra në çadër) duhet të jetë të paktën 2.5 (dy pikë pesë) m;
- c) të gjitha kushtet e përcaktuara për tipin A, në pikën 1, përvèç shkronjave “b” dhe “c”.

3. Kushtet minimale që duhet të plotësojë një stacion plazhi, në plazhet e tipit AB, janë, si më poshtë vijon:

- a) për hapësirat, të cilat përbajnë elementet e tipologjisë së plazhit të tipit A, do të zbatohen kriteret e plazhit të tipit A, sipas pikës 1, të këtij neni;
- b) për hapësirat, të cilat përbajnë elementet e tipologjisë së plazhit të tipit B, do të zbatohen kriteret e plazhit të tipit B, sipas pikës 2, të këtij neni.

4. Për plazhin e tipit C, njësia e vetqeverisjes vendore merr masa për vendosjen e tabelave informuese, të vendosura në vende të dukshme, me numrat e telefonit të Ambulancës, Policisë, Zjarrfikëses, Kapitanerisë së Portit, QNOD-it;

5. Nuk mund të ndalohet apo të kufizohet, në asnjë formë dhe në asnjë kohë, aksesi i publikut në hapësirat e plazheve. Subjektet e veprimtarisë së stacionit të plazhit kanë detyrimin për të krijuar kushtet e kalimit lirisht të publikut dhe moscenimin në ndonjë formë të kësaj të drejte, si dhe sigurimin e kushteve të kalimit lirisht të personave me aftësi të kufizuar.

6. Në rastin e bllokimit të rrugëve ekzistuese nga subjektet ushtruese të veprimtarisë së stacionit të plazhit, njësia e vetëqeverisjes vendore merr masa të menjëherëshme për lirimin e këtyre rrugëve vullnetarisht nga këto subjekte ose të ndërtimit të rrugëve të reja, me parametrat e duhur për të mundësuar aksesin e publikut në plazh.

7. Në stacionet e plazhit, në hapësirën midis bregut dhe zonës së çadrave, nuk lejohen shitësit ambulantë.

Neni 9

Kërkesat për sigurinë në stacionet e plazhit

1. Të gjitha stacionet e plazhit kanë detyrimin e vendosjes, mirëmbajtjes dhe ruajtjes së kushteve higjenike dhe të sigurisë për jetën, të caktuara në këtë rregullore, si dhe kanë detyrë të ruajnë pastërtinë e detit dhe bregut të detit për zonën para stacionit të plazhit, si dhe ta mbrojnë atë nga ndotjet e dëmtimet me shpenzimet e tyre.

2. Kërkesat për sigurinë të përcaktuara në këtë nen zbatohen edhe për plazhet publike.

3. Të gjitha stacionet e plazhit kanë për detyrë të respektojnë kriteret dhe kushtet për sigurinë e shëndetit dhe jetës të përcaktuara me akte ligjore dhe nënligjore në lidhje me aktivitetet e ndryshme specifike që zhvillohen e ofrohen në stacionet e plazhit.

4. Të gjitha stacionet e plazhit duhet të garantojnë shërbimin me vrojtues plazhi përgjatë gjithë kohës që subjekti ushtron aktivitetin e tij, për çdo 80 (tetëdhjetë) m vijë lineare bregdetare. Për stacionet e plazhit, me vijë lineare bregdetare mbi 80 (tetëdhjetë) m, pajisjen me pika vrojtimi për çdo fraksion 80 (tetëdhjetë) m linear. Edhe stacionet e plazhit me vijë lineare bregdetare nën 80 (tetëdhjetë) m kanë detyrimin të kenë vrojtues plazhi.

5. Të gjitha stacionet e plazhit duhet të kenë:

a) Sinjalizimin dhe kufizimin me bova (me diametër 22 cm) me ngjyrë të kuqe, të lidhura me litar pluskues me njëra tjetrën, çdo 30–50 m të hapësirës ujore përpëra stacionit të plazhit të dedikuar për not, e cila duhet të jetë deri në:

i. 200 (dyqind) m nga bregu për plazhet e tipit A;

ii. 100 (njëqind) m nga bregu për plazhet e tipit B

Deri në thellësinë 1.6 m (një pikë gjashtë) të vendosen bova (me diametër 22 cm), me ngjyrë të bardhë, e cila sinjalizon pushuesit për zonën e sigurt për notim. Bovat duhet të janë të mirankoruara dhe të kontrollohen periodikisht nëse ato kanë lëvizur nga pozicioni i tyre nga dallgët, era apo shkaqë të tjera.

b) sinjalizimin e zonave të përdorimit të mjeteve lundruese për argëtim, zonat për përdorimin dhe ankorimin e mjeteve lundruese me ose pa motor, jashtë zonave të përcaktuara për not sipas shkronjës "a", më sipër, duhet të janë të kufizuara, duke ofruar vende për ankorim (kalata), vendparkim në tokë dhe bova për përcaktimin e korridoreve për atrimin dhe parkimin në tokë të mjeteve ujore me ose pa motor. Në zonat e përdorimit dhe ankorimit të mjeteve lundruese për argëtim, aktivitetet e notimit janë të ndaluara. Sinjalizimin me tabela informuese në shqip dhe në anglisht, në vend të dukshëm pranë bregut të detit "Zonë e ndaluar për notim" dhe "No swimming area";

c) vendosjen e flamujve me shkop, çdo ditë, gjatë sezonit të verës; subjekti që ushtron veprimtarinë e stacionit të plazhit duhet të vendosë një flamur në përputhje me kushtet e motit dhe të detit, i cili mund të ndryshohet gjatë ditës, nëse ndryshojnë kushtet e motit apo të detit, si më poshtë vijon:

- i. flamur i gjelbër – lejohet notimi;
- ii. flamur i verdhë – notim me masa mbrojtëse;
- iii. flamur i kuq – ndalohet notimi.

Në shkopin e flamurit duhet të ketë edhe një tabelë svaruese në shqip dhe anglisht për sinjalistikën me flamur dhe me informacion mbi kushtet e plazhit. Shkopi i flamurit duhet të jetë 3.5 m i lartë, i dukshëm në të gjithë zonën;

ç) Pajisjen e çdo stacioni të plazhit me pikë vrojtimi, pajisjet e të cilave janë përcaktuara në shtojcën nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi. Pika e vrojtimit duhet:

- i. të jetë e vendosur në pozicion qendror referuar strukturës së stacionit të plazhit ose vijës bregdetare në përdorim;
- ii. të jetë e avancuar në krahasim me vijën e parë të çadrave;
- iii. të ketë një fushë pamjeje dhe veprimi të lirë;
- iv. të jetë mbulesa e çadrës ose tendës së pikës së vrojtimit me pëlhurë të kuqe, lehtësisht e identifikueshme, ku të shkruhet qartë "VROJTUES PLAZHI"/ "LIFEGUARD";

d) Pajisjen e plazheve publike me pika vrojtimi, pajisjet e të cilave përcaktohen në shtojcën nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi. Distancat për pajisjen me pikavrojtimi në këto plazhe, për aq sa është e mundur, do të janë sa distancat e parashikuara për pikat e vrojtimit në stacionet e plazhit dhe duhet të ketë lartësi 3 m dhe fushë pamjeje e veprimi të lirë;

dh) Çdo "stacion plazhi" dhe "plazh publik" duhet të garantojë shërbimin me vrojtues plazhi. Vrojtuesi i plazhit punësohet nga subjekti publik dhe privat që ka në përdorim/administrim hapësirën e plazhit dhe duhet të garantohet përgjatë gjithë periudhës së ushtrimit të veprimtarisë së plazhit. Në imugesë të shërbimit me vrojtues plazhi, struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e turizmit merr masa administrative në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektim dhe legjislacionin në fuqi për turizmin,

6. Për plazhet publike cilat administrohen nga njësitë vendore dhe plazhet e tipit Cnë të cilat nuk mund të ofrohen kriteret e sigurisë, duhet të vendosen tabela informuese lehtësish të dallueshme, me mbishkrime (në shqip e në anglisht) "KUJDES! - KY PLAZH NUK KA VROJTUES PLAZHI." / "ATTENTION! - THIS BEACH HAS NO LIFEGUARD.".

7. Çdo stacion plazhi dhe pikë vrojtimi duhet të ketë të afishuar:

7.1. kanalet për komunikim emergjence, si:

- a) shërbimi i urgjencës mjekësore;
- b) Policia e Shtetit dhe Policia Kufitare;
- c) zjarrfikëset;
- ç) Kapitaneria Detare;
- dh) Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD).

7.2 Në mënyrë të dukshme, këshillat drejtuar pushuesve, në gjuhën shqipe dhe angleze, si më poshtë vijon:

- a) Noto vetëm në zonat e autorizuara dhe me sinjalistikë.
- b) Respekto flamurin dhe informacionin e afishuar.
- c) Ndalohet notimi nën ndikimin e alkoolit apo drogave.
- ç) Mos noto, nëse ke ndonjë problem fizik.
- d) Pusho për një orë pas ngrënies, para se të shkosh për notim.
- dh) Të miturit nën 16 vjeç duhet të jenë gjithmonë nën mbikëqyrjen e më të rriturve.
- e) Mos u hidh nga shkëmbinj apo platforma përveç vendeve të autorizuara me sinjalistikë.
- ë) Ndiq udhëzimet e vrojtuesit (rojës së shpëtimit të jetës).
- f) Mbaj pastër mjedisin.
- g) Në rast EMERGJENCE në det, telefono 112.

8. Lejohet aktiviteti i dhënies me qira të pedaloneve apo i mjeteve të tjera ujore jo motorike dhe përdorimi i tyre duhet të bëhet jashtë zonës së notimit, bazuar në aktet nënligjore në fuqi. 9. Lëvizja e motorëve të ujit apo varkave motorike duhet të bëhet nga korridoret hyrës dalës të miratuar nga NJVV-ja përkatëse ose në stacionet sezionale të ankoram bregëzimit.

10. Ofrimi i shërbimeve dhe plotësimi i kushteve të përmendura më sipër bëhet me shpenzimet e mbajtësit të autorizimit të stacionit të plazhit.

11. Kontrata e përdorimit të hapësirës së plazhit mund të parashikojë kritere më të detajuara të stacionit të plazhit sipas tipologjisë së plazhit.

Neni 10

Detyrat e vrojtuesit të plazhit

Vrojtuesi i plazhit ka si detyrim:

- a) të ketë njohuri për kuadrin ligjor të funksionimit të stacionit të plazhit, teknikat e shpëtimit dhe dyluftimit në ujë, dhënen e ndihmës së parë mjekësore, për hidrometeorologjinë, karakteristikat e brigjeve shqiptare dhe rrymat ujore në to, si dhe mbi sigurinë e mjedisit ujor me referim të veçantë për të njohur faktorët e rrezikshëm që mund të jenë të pranishëm në ujë;

- b) të jetë i angazhuar ekskluzivisht në shërbim të vrojtim-shpëtimit dhe të jetë i pranishëm përgjatë gjithë kohës pranë pikës së vrojtimit, përjashtuar rastet emergjente;
- c) të mbajë të veshur uniformën e vrojtuesit me ngjyrë të kuqe gjatë shërbimit. Uniforma ka të shkruar në pjesën e përparme logon, në krahun e majtë, simbolin e flamurit shqiptar, në krahun e djathë numrin e matrikullës dhe, në pjesën e pasme, në mënyrë të dukshme qartë, "Vrojtues plazhi" dhe "Lifeguard";
- c) të sinjalizojë pranë organeve kompetente në rastet kur verifikohen kundërvajtje në territorin e stacionit të plazhit dhe në hapësirën ujore përballë tij;
- d) të kujdeset periodikisht për sinjalistikën ujore dhe territoriale të stacionit të plazhit dhe të bëjë zëvendësimin e materialeve të konsumuara në kutinë e ndihmës së shpejtë mjekësore, si dhe të mbajë në eficencë mjetet e shpëtimit;
- dh) të ketë certifikatën dhe kartën ekuivalente të certifikatës brenda afatit të vlefshmërisë, lëshuar nga Qendrat e Formimit Profesional. Rinovimi i saj bëhet sipas rregullores së subjektit certifikues, me qëllim monitorimin e aftësive fizike, mendore të vrojtuesit.

Neni 11

Kritere të përgjithshme për strukturat në stacionet e plazhit

1. Strukturat dhe pajisjet e përdorura në stacionin e plazhit përveç instalimeve sanitare publike dhe pikat e vrojimit, duhet të çmontohen me përfundimin e afatit të parashikuar në kontratë për sezonin e plazhit të vitit respektiv, për t'i kthyer plazhit karakterin e tij natyror.
2. Strukturat e përdorura duhet të janë:
 - a) struktura lehtësishët të çmontueshme, të realizuara me elemente, të tilla si: druri, panele të parafabrikuara të lehta, mbulesa të lehta, PVC, që nuk e dëmtojnë mjedisin në momentin e zhvendosjes;
 - b) pajisje të lëvizshme, të instalueshme vetëm për periudhën e sezonit të plazhit dhe të cilat mund të hiqen me mbylljen e tij, si çadra, krevate plazhi, tavolina, akseset për të shkuar në det, struktura të vogla prej druri etj.
 - c) struktura të sigurta, të kenë sistemet e montimit me bulona, strukturat e shërbimeve mund të janë të përkohshme.
3. Në stacionet e plazheve mund të ketë 3 tipologji çadrash:
 - a) me kashtë;
 - b) me pëlhurë (tekstil);
 - c) tendë kashte apo pëlhure.
4. Brenda brezit të shërbimeve mund të realizohen këto struktura: kioskë menaxhimi për plazhin, kabina, shërbime higjenike, depo, pika vrojtimi/ , hapësirë për rojën e plazhit (në rastin e plazhit publik), beach-bar, hapësirë për fëmijët, hapësira relaksimi me tavolina, hapësirë për vendosjen e bicikletave. Materialet që lejohen të përdoren për këto struktura janë: dru, kashtë, kallama, tenda të

lehta, struktura të çmontueshme, në mënyrë që të magazinohen gjatë sezonit të dimrit dhe të transportohen përgjatë zonës bregdetare, në rast nevoje.

Neni 12

Respektimi i kushtit për nivelin e lejuar të zhurmave

Çdo stacion plazhi është i detyruar të respektojë nivelin kufi të zhurmave të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për zhurmat, si dhe/ose në planet vendore të miratuara nga organet e vetëqeverisjes vendore.

Neni 13

Inspektimi

1. Struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e turizmit kryen inspektime për të verifikuar respektimin e kushteve dhe kritereve të përcaktuara në këtë rregullore nga subjektet që kanë lidhur një kontratë qiraje/përdorimi e hapësirës për stacion plazhi.
2. Në rast konstatimi të shkeljeve, të cilat përbëjnë kundërvajtje administrativerast, struktura përgjegjëse inspektuese merr masa administrative në përputhje me parashikimet e nenit 71 të ligjit nr. 93/2015 "Për turizmin", i ndryshuar, dhe në rast përsëritje të shkeljeve administrative deri në zgjidhjen e menjëherëshme të kontratës.

Neni 14

Dispozitë kalimtare

1. Subjektet, të cilët kanë kontratë të vlefshme qiraje/përdorimi të hapësirave të stacionit të plazhit, deri në vitin 2025, do të zhvillojnë aktivitetin e tyre deri në perfundimin e afatit të kontratës, duke respektuar kushtet dhe kërkesat e parashikuara në këtë rregullore.
2. Përashtimi për bashkinë Fier dhe Divjakë, në stacionet e plazhit, që nuk ka struktura akomoduese pranë apo në afersi të hapësirës së plazhit, nuk zbatohet kriteri i parashikuar në shkronjën "b", pika 3, e nenit 7 dhe subjekti, përveç kritereve të parashikuara në shkronjat "c" dhe "ç" të pikës 3 të nenit 7, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:
 - a) të jetë i rregjistruar si person fizik / tregtar apo juridik, për ushtrimin e veprimtarisë si strukturë shërbimi;
 - b) të disponojnë një strukturë shërbimi me kapacitet mbi 20 tavolina dhe të ketë hapësirë plazhi, pranë strukturës së shërbimit.
3. Subjektet e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, paraqesin kërkesën me shkrim pranë Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe për dijeni NJVV, së bashku me dokumentacionin që vërteton plotësimin e kritereve të parashikuara në këtë rregullore. Agjencia Kombëtare e Bregdetit i përcjell për shqyrtim kërkesën GTSHA-së dhe trajtimin e aplikimit ndiqet e njëjtë procedurë e parashikuar në nenin 7 të kësaj rregulloreje. Numri maksimal i çadrave që vendosen në stacionin e plazhit pranë strukturës së shërbimit është 50 çadra.

SHTOJCA I

KONTRATA MODEL PËR PËRDORIMIN E HAPËSIRËS SË PLAZHIT

Sot, më datë [•], në [•], nënshkruhet kjo kontratë për përdorimin e hapësirës së plazhit (Kontrata) ndërmjet palëve, si më poshtë:

Agjencia Kombëtare e Bregdetit përfaqësuar nga z./zngj. [•], në cilësinë e Drejtorisë së Agjencisë, këtu e më poshtë referuar si "Dhënësi"

dhe

[•] person fizik/tregtar apo juridik, i/e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, me numër unik identifikimi [•], me seli në adresën: [•], përfaqësuar nga z./zngj. [•], në cilësinë e përfaqësuesit ligjor, këtu e më poshtë referuar si "Përdoruesi".

dhe

Njësia e Vetëqeverisjes Vendore, përfaqësuar nga, këtu e më poshtë referuar si "Përfituesi",

Meqenëse:

A) Përdoruesi operon një strukturë akomoduese apo një strukturë shërbimi sipas pikës 3 të nenit 7 të rregullores miratuar me vendimin nr. [•], datë [•], të Këshillit të Ministrave, të ndodhur në [•], me një kapacitet prej [•] dhomash/tavolinash;

B) Mbështetur në vendimin nr. [•], datë [•], të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores 'Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit'", përdoruesi ka aplikuar nëpërmjet portalit *e-Albania*/ apo për parashikimet e pikës 3 të nenit 14 të rregullores miratuar me vendimin e mësipërm, ka depozituar kërkesën pranë Agjencisë Kombëtare të Bregdetit për marrjen në përdorim të hapësirës së plazhit prej [•] m², të ndodhur në [•];

C) Përdoruesi, mbështetur në vendimin nr. [•], datë [•], të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores 'Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit'", pas përfundimit të procesit të përzgjedhjes, është njoftuar, në datën [•], për miratimin e kërkesës për marrjen në përdorim të hapësirës së plazhit prej [•] m² të ndodhur në [•].

Për sa më sipër dhe bazuar në parashikimet e nenit 659 e në vijim e Kodit Civil, palët bien dakord, si më poshtë vijon.

Neni 1 Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate është dhënia në përdorim e hapësirës së plazhit, të ndodhur në [•], me sipërsaqe prej [•] m², në administrim të bashkisë _____, bazuar në hartën e miratuar nga Komiteti i Menaxhimit të Sezonit Turistik.

Neni 2
Qëllimi i përdorimit

Qëllimi i kësaj kontrate është dhënia në përdorim e hapësirës së plazhit për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, sipas kushteve dhe kritereve të parashikuara në vendimin nr. [•], datë [•], të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores, ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”.

Neni 3
Kohëzgjatja

1. Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë prej ___ viti/vjetësh, me të drejtë përdorimi, të paktën për periudhën 1 maj – 15 tetor të çdo viti, dhe hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga palët.
2. Palët bien dakord që kontrata do të përfundojë me përfundimin e afatit dhe nuk rinovohet.

Neni 4
Të drejtat dhe detyrimet e përfituesit

1. Përfituesi gjëzon të drejtën e përfitimit të pagesës vjetore për stacionin e plazhit, objekt i kësaj kontrate.
2. Përfituesi ka detyrimin të dorëzojë, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate, hapësirën e plazhit të përcaktuar në nenin 1, të lirë për t'u shfrytëzuar për qëllimin e kësaj kontrate. Në momentin e dorëzimit hartohet procesverbal i dorëzimit të hapësirës së plazhit që jepet në përdorim.
3. Përfituesi dorëzon një kopje të procesverbalit tek Dhënësi brenda 10(dhjetë) ditëve nga dorëzimi i hapësirës së plazhit.
4. Përfituesi ka detyrimin të mbikqyrë vendosjen e numrit të çadrave të miratuara nga GTSHA-ja për stacionin e plazhit, objekt i kësaj kontrate gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj.
4. Përfituesi i garanton përdoruesit gjëzimin e qetë të hapësirës së plazhit, objekt të kontratës gjatë gjithë periudhës së dhëne në përdorim.
5. Përfituesi garanton aksesin e publikut në hapësirën e plazhit objekt kontrate dhe merr masa të menjëherëshme në rast bllokimi të rrugëve sipas parashikimeve të nenit 8 të vendimit nr. [•], datë [•], të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”.

Neni 4
Të drejtat dhe detyrimet e dhënësit

1. Dhënësi ka të drejtë të kontrollojë dhe monitorojë në çdo kohë respektimin e kushteve, kërkesave dhe kritereve të ushtrimit të veprimtarisë, të përcaktuara në vendimin nr. [•], datë [•], të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”.
2. Dhënësi ka detyrimin të bashkëpunojë me përfituesin për respektimin e parashikimeve të vendimit nr. [•], datë [•], të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”.

Neni 5
Të drejtat dhe detyrimet e përdoruesit

1. Përdoruesi ka të drejtë të përdorë e të gjëzojë hapësirën e stacionit të plazhit të marrë në përdorim dhe përmirësimet e bëra në të, për gjithë kohëzgjatjen e kontratës.

2. Përdoruesi detyrohet që:

- a) të përdorë hapësirën e plazhit, objekt të kësaj kontrate, vetëm për qëllimin e parashikuar në nenin 2;
- b) të ushtrojë veprimtarinë në përputhje me planin e operimit të paraqitur në momentin e aplikimit për marrjen në përdorim të hapësirës së plazhit;
- c) të plotësojë e të respektojë kushtet minimale të stacionit të plazhit sipas tipologjisë, kërkesat e sigurisë në stacionet e plazhit dhe kriteret e përgjithshme për strukturat në stacionet e plazhit në përputhje me vendimin nr. [•], datë [•], të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’” ;
- ç) të respektojë kushtet për nivelin e lejuar të zhurmave sipas akteve ligjore/nënligjore në fuqi ;
- d) të bashkëpunojë me çdo autoritet publik përgjegjës për monitorimin dhe inspektimin e plazhit e të veprimtarive turistike, si dhe t'i vërtë në dispozicion të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin e nevojshëm për të verifikuar përbushjen e detyrimeve ligjore përkatëse
- dh) të paraqesë çdo dokumentacion të nevojshëm për përbushjen e kritereve dhe standardeve minimale për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, në rast kontrolli apo inspektimi nga organet përgjegjëse ;
- e) të ketë të punësuar vrojtues plazhi përgjatë gjithë sezonit të ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit.
- ë) të afishojë, certifikatën e kualifikimit të vrojtuesit të plazhit ose kopja e saj së bashku me NIPT-in dhe lejet që ai disponon
- f) të krijojë kushte për kalimin lirisht të publikut dhe të moscënojë në ndonjë formë këtë të drejte, si dhe të sigurojë e kushte të kalimit lirisht të personave me aftësi të kufizuar.

3. Përdoruesi nuk ka të drejtë të japë me nënqira hapësirën e plazhit të marrë në përdorim, sipas kësaj kontrate.

Neni 6
Penalitetet

1. Në rast të mospërbushjes së detyrimeve të përcaktuara në vendimin nr. [•], datë [•], të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”, ndaj përfituesit zbatohen parashikimet e legjisacionit në fuqi për inspektimin dhe nenit 71 të të ligjit 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar.

2. Në rast se konstatohet që masat për përbushjen e detyrimeve vazhdojnë të mos realizohen nga përdoruesi, dhënësi vetë apo nëpërmjet njofimit nga përfituesi, ka të drejtë të zgjidhë menjëherë kontratën për mospërbushje të detyrimit kontraktor.

Neni 7

Zgjidhja e kontratës

1. Kontrata zgjidhet me përfundimin e afatit të përcaktuar në nenin 3, të kontratës.
2. Kontrata mund të zgjidhet para afatit:
 - b) me marrëveshje midis palëve;
 - c) kur prona humbet tërësisht ose dëmtohet, për shkak të një force madhore, aq sa nuk mund të ushtrohet veprimtaria e stacionit të plazhit;
 - ç) kur përdoruesi shkel në mënyrë të përsëritur detyrimet e marra përsipër sipas kontratës, mbështetur në kushtet, kërkesat dhe kriteret e parashikuara në vendimin nr. [•], datë [•], të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit"
3. Dhënësi apo Përfituesi kanë të drejtë të kërkojnë zgjidhjen e kontratës kur përdoruesi shkel detyrimet e marra përsipër. Në këtë rast, dhënësi apo përdoruesi respektojnë procedurën e parashikuar në legjislacionin në fuqi për inspektimin.
4. Kontrata mund të zgjidhet nga dhënësi edhe për shkaqe të interesit publik. Në këtë rast, përdoruesi ka të drejtën e rimbursimit të pagesës së kryer, nga përfituesi për afatin e mbetur.
5. Me përfundimin e kontratës, përdoruesi duhet të kthejë hapësirën e plazhit në të njëjtën gjendje që e ka marrë në dorëzim; në të kundërt, detyrohet të kryejë të gjitha rregullimet me shpenzimet e veta ose të paguajë vlerën përkatëse të shpenzimeve të përcaktuara me një ekspert të emëruar me marrëveshje dypalëshe.
6. Me përfundimin e kontratës, përdoruesi ka të drejtë të heqë përmirësimet e ndashme nga hapësira e plazhit, por pa dëmtuar atë. Dhënësi nuk bën kompensimin financiar të investimeve të kryera nga përdoruesi.

Neni 8

Dispozitat e fundit

1. Për gjithçka që nuk është shprehur posaçërisht në kontratë, palët do t'u referohen dispozitatave të Kodit Civil dhe vendimit nr. [•], datë [•], të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit".
2. Kontrata përbën marrëveshjen e plotë ndërmjet palëve lidhur me objektin e saj dhe ka epërsi mbi çdo marrëveshje të mëparshme me gojë apo me shkrim midis palëve.
3. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë ndërmjet palëve lidhur me kontratën apo ndonjë marrëveshje tjeter, ose dokumenti të nënshkruar nga palët për zbatimin e kontratës, do të zgjidhet nga palët me mirëkuptim; në të kundërt, zgjidhja e mosmarrëveshjes do të jetë në kompetencën e gjykatës administrative përkatëse.
4. Kontrata është hartuar në katër kopje origjinale, në gjuhën shqipe me të njëjtën vlerë secila.

SHTOJCA II

1. Pika e vrojtimit duhet të ketë këto pajisje:
 - a) një barelë pluskuese shpëtimi;

- b) 2 kamerdare rrighthspëtimi 63 = cm me litar pluskues 15–25 m të gjatë;
- c) një bovë bayëatch;
- ç) një palë dylbi;
- d) një megafon;
- dh) bilbil plastik;
- e) një rul statik me jo më pak se 200 m litar pluskues të gjatë në të;
- ë) një mjet pluskues shpëtimi (surfboard ose pedalon).
- f) kutia e ndihmës së shpejtë mjekësore (2 bombola oksigjeni mbi 1 L, 150 atm, me reduktor presioni me manometër kontrolli, pompë dore oksigjenimi, hapëse goje, poker mask, aparat matës tensioni, ampulë adrenalinë, kollare qafë, shiringë sterile, termometër, doreza higjenike njëpërdorimëshe (5 copë), 1 flakon dezinfektant me betadinë, 3 flakonë solucioni fiziologjik (chlorur sodium - 0.9%) 500 ml, 10 garza sterile 10x10, 2 garza sterile 18x40, 2 peceta sterile njëpërdorimëshe, 2 pinca sterilë njëpërdorimësh, fashë llastiku e masës mesatare, pambuk absorbuës, 2 leukoplastë të madhësive të ndryshme, 2 rrole leukoplasti me gjërsi 2.5cm, gërvshërë, 3 llastikë hemostatikë, akull i gatshëm, qese higjenike njëpërdorimëshe).
- Artikujt e kutisë së ndihmës mjekësore duhet të jenë brenda standardeve dhe afateve të përdorimit. Nuk duhet të ekspozohen ndaj diellit dhe temperaturave të larta.